

Fletëpalosje për përparimin tonë dhe të ardhmen financiare

Përparimi ynë përpara “COVID-19”-ës

Gjatë pesë viteve të fundit, SDP-ja ka bërë investime të mëdha në shkollat e saj, gjë që ka çuar në përmirësimin e shkollave dhe të rezultateve të nxënësve për katër vjet rresht. Rrethi shkollor:

- Ka rritur numrin e mësuesve, këshilluesve dhe infermierëve në shkollat tona
- Ka shtuar numrin e shërbimeve socio-emocionale dhe të shërbimeve përkrahëse për nxënësit
- Ka përmirësuar infrastrukturën bazë dhe sigurinë mjedisore në godinat e shkollave tona
- Ka ndërtuar laboratorë të rinj informatike në çdo shkollë dhe ka modernizuar më tej klasat

Parashikimi ynë financiar përpara “COVID-19”-ës

Përpara pandemisë “COVID-19”, SDP-ja kishte rifituar një bazë të shëndoshë financiare me:

- Një vlerësim kreditor të nivelit të investimit, për herë të parë që prej vitit 1977
- Një bilanc pozitiv fondesh në fund të vitit (fondi i emergjencave) për pesë vjet rresht
- Një parashikim të buxhetit pesë vjeçar, i cili mbeti i fuqishëm pavarësisht investimeve të vazhdueshme në shkollat tona

Parashikimi ynë financiar tani, pas “COVID-19”-ës

- Ndikimi financiar i “COVID-19”-ës në rrethin tonë shkollor ka qenë katastrofik.
- Deri në prill të 2020-ës, kaluam nga një parashikim financiar me buxhete të balancuara çdo vit për pesë vitet e ardhshme në një parashikim ku çdo vit do të ketë hendeqe të mëdha financimi, çka do të çojë në një deficit prej 1 miliard dollarësh gjatë pesë vjetëve.
- Falë përpjekjes së suksesshme të avokimit në “Fazën I” dhe përdorimit të “fondit të emergjencave”, kemi mbyllur hendekun fillestar të financimit për vitin shkollor 2020-2021 dhe kemi zvogëluar deficitin financiar pesë vjeçar nga 1 miliard dollarë në **700 milionë** dollarë, edhe pse kjo shumë është, gjithsesi, shkatërruese.
- Tani parashikojmë që kostot e reja, që do të përdoren për të mbështetur realizimin e vitit shkollor 2020-2021 si vit shkollor i sigurt dhe i suksesshëm për të gjithë nxënësit dhe personelin, mund të arrijnë në 64 milionë dollarë.*
- Për të ruajtur përparimin që kemi pasur në drejtim të mbështetjes së shkollave dhe nxënësve tanë, ne duhet të vazhdojmë fushatën e avokimit “Fund Our Schools”.

* Mbështetur në vlerësimin e Shoqatës së Mbikëqyrësve të Shkollave sipas të cilit kostoja për mbështetjen e nxënësit është 490 dollarë për nxënë, për mbështetje në rastin e pandemisë “COVID-19”, duke përfshirë protokollet e pastrimit, akomodimet në ndërtesa, teknologjinë, pajisjet mbrojtëse, etj.

